

Kuvendi i Kosovës
Seanca Plenare e Kuvendit
Seanca nr.2002/19
Prishtië, më 07 nëntor 2002, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.
Kryesuesi pasi konstatoi numrin e deputetëve prezentë në seancë gjithsej 98, propozoi këtë

REND TË DITËS

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Procesverbali nga seanca e kaluar;
- 3.Shqyrtimi i "P/ligjit për Inspektoratin e Punës-2002/9";
- 4.Parashtrimi i pyetjeve.

1.Miratimi i rendit te dites

Sabri Hamiti: Në një kontratë kushtetuese të Serbisë e të Malit të Zi, në preambulë është imlikuar Kosova duke u përpjekur që të paragjykohet statusi i saj i ardhshëm statusi i saj i ardhshëm politik.

E gjykojmë këtë si një provokim, për më tepër do të thosha, një agresion kushtetues ndaj Kosovës.

Është edhe një e keqe që në hapa më të hershëm, qoftë si pjesëmarrës apo përkrahës është implikuara në të edhe Bashkësia Evropiane përmes Solanës.

Unë kërkoj sot që kjo çështje kaq e rëndësishme të vëhet me procedurë të shpëjtë në rend dite të Kuvendit dhe në fund të hartohet dokumenti përkatës.

Fatmir Limaj :Parlamenti, si organ më i lartë i Kosovës, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë lidhur me Kosovën, ne mbështesim qëndrimin paraprak që kjo çështje e rëndësishme të futet në rend të ditës dhe ky Parlament dhe deputetët e Parlamentit të Kosovës, ta thënë fjalën e tyre, fjalën të cilën e kanë obligim ta paraqesin qëndrimin e qytetarëve të Kosovës, dhe t'i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosoves.

Prandaj, në emër të Grupit parlamentar të Prtisë Demokratike të Kosovës edhe ne kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës sa më shpjet të shtrohet dhe të jetë një ndër pikat kryesore dhe të hapet debat për këtë çështje nga debati nga i cili do të delë dokumenti.

Rada Trajkovic: dëshiroj t'i paraqes qëndrimet e kolacionit „Kthimi”. Ju e dini që Rezoluta 1244 është aprovuar nga vendët më të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara. Për atë dokument ka herë e kanë dhënë mendimin e vetë organet shtetërore të Jugosllavisë dhe Sërbisë. Kuvendi i Kosovës asnjë herë nuk është deklaruar lidhur me këtë Rezolutë. Mendoj që do të ishte shumë mirë që sotë në rendë të ditës të vihët si pikë deklarimi i Kuvendit të Kosovës për përkrahjen e Rezolutës 1244.

Bujar Dugolli: gjatë këtyre ditëve ka pasur reagime të institucioneve të Kosovës, por fatmirsishtë dje ka reaguar ndaj kësaj që u ngrit Grupi parlamentar i LDK-së dhe i PDK-së ndaj këtij provokimi që i është bërë Kosovës, ka pasur reagime edhe nga qarqet tjera ndërkombëtare të cialt ne i pëshëndesim dhe i falenderojmë që po i tregojnë Sërbisë me atë dokument që e ka hartuar se nuk është e drejtë e tyre të përzihen në punët e Kosovës dhe të prejudiojnë statusin e Kosovës.

Ne si grup parlamentar i Alenacës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkojmë që kjo çështje të futet në rendin e ditës dhe pas një debati të miratohet një rezolutë për këtë çështje.

Mahir Yagcilar: Kosova qeveriset nga administrata e OKB-së në bashkpunim me organet e përkohshme vetëqeverisese të Kosovës. Partia Demokratike Turke i mbështetë propozimet e tri gurpeve parlamentare (LDK, PDK, AAK) është që kjo çështje të shqyrtohet në rendin e ditës.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare, që rendi i ditës të plotësohet edhe me pikën: miratimi i Rezolutës së Kuvendit të Kosovës për kundërshtimin e përfshirjes së Kosovës në preambullën e Projekt-Kartës Kushtetuese të Unionit Sërbi-Mali i Zi.

Rezultati ishte:
Për-----80;
Kundër-----18;
Abstenuan----0.

Rada Trajkovic: dëshiroj që Kuvendit të votoj edhe për propozimin tim. Kryesuesi: Kosova administrohet nga Rezoluta e OKB-së dhe të gjitha institucionet e saja janë ndërtuar në bazë të sajë.

Bajram Kosumi: propozimi i znj. Trajkovic nuk meriton të votohet .

Hidajet Hyseni: propozimi i znj. Trajkovic nuk është në harmoni me procedurën e Kuvenditë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e znj. Trajkovic.

Rezultai ishte :
Për -----0
Konstatim: askush nuk e përkrahu propozimin e sajë.